



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 176 Prot

Shkodër me 17.03 2025

VENDIM

Nr. 07, Datë 13.03.2025

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2024 TË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Ligjin 97/2023 "Per Buxhetin e Vitit 2024", VKQ Shkoder nr.21, datë 28.12.2023 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024 dhe PBA Përfundimtare 2024-2026", Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim**,

VENDOSI;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe tabelat e realizimit të buxhetit, pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve
 - c) Projektet e investimeve me financim të brendshëm.
 - d) Treguesit ekonomik financiarë.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

